



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"

UNIVERSITY OF PRISTINA

FAKULTETI I NDËRTIMTARISË – CIVIL ENGINEERING FACULTY

Rr. Agim Ramadani, ndertesa e "Fakultetit Teknik", 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383-38-548 644

URL: <http://www.fna.uni-pr.edu>

Mail: [fn@uni-pr.edu](mailto:fn@uni-pr.edu)

Ref. nr. 2214/1 Prishtinë 27.06. 2022

PUBLIKIMI I ABSTRAKTIT TË PUNIMIT TË DIPLOMËS MASTER

DEPARTAMENTI KONSTRUKTIV

Studenti **Valdrin Gashi** ka dorëzuar dorëshkrimin e punimit të diplomës Master me titull: " **Vlerësimi I stabilitetit dhe sanimi i urës në Vranoc** " në programin e studimeve Master Hidroteknik dhe dorëshkrimi është në procedurë të vlerësimit përfundimtar deri në vendimin e këshillit të Fakultetit të Ndërtimtarisë. Sipas rregullores për studimet Master Shkencor të Universitetit të Prishtinës, abstrakti i shkurtër i punimit të diplomës bëhet publik për periudhën kohore prej pesë ditësh nga dita e shpalljes.

**Abstrakt**

Urat si vepra inxhinierie kanë filluar të ndërtohen qysh në kohët e lashta për kalimin e pengesave të ndryshme të terrenit. Krahas evoluimit të njeriut vazhdimisht kanë evoluuar edhe materialet e ndërtimit, mënyra e ndërtimit si dhe rregullat e projektimit.

Prandaj gjatë shfrytëzimit të urave si struktura mundë të paraqiten probleme të ndryshme që lindin si pasojë e veprimeve të paparashikueshme mirëpo edhe ndonjëherë të neglizhuar qysh në fazën e projektimit detal të strukturës, veprime këto që në strukturë mundë të shkaktojnë lodhje të elementeve strukturore dhe humbje në jetëgjatësinë e shfrytëzimit të urës po ashtu mundë të vie deri te shkatërrimi i plotë i strukturës. Probleme këtu shfaqen në shumë vende të botës dhe janë problematika që kërkojnë një shtjellim më të detajuar.

Në Kosovë kemi raste të dëmtimeve strukturore në ura të ndryshme mbi lumenjtë gjatë rritjes së prurjes së lumenjëve ka ardhur deri të degradimi i elementeve strukturore , mundë të përmendim rastin tonë Ura në Fshatin Vranoc, Ura në Gjakovë të Hasit dhe shumë raste tjera.

Pasi që është identifikuar ura e dëmtuar është bërë një vizitë e parë si inspektim vizuel dhe pas disa ditëve një inspektim më i detajuar. Vlerësimet në strukturë janë kryer me metoda jodestruktive pasi që si rast studimore kryesisht jemi ndalur në vlerësimin e stabilitetit të urës (qendrueshmërinë e urës) mirëpo kemi bërë edhe vlerësimin e materialeve ndërtimore , betonit dhe evidentimi e armaturës në strukturë. Ndërsa me anë të metodave jo destruktive janë kryer ekzaminimi i betonit në strukturë me sklerometer sipas EN 12504-2 dhe vlerësimi sipas EN 13791, vlerësimi i diametrit të armaturave dhe pozicionit të tyre në strukturë janë bërë me Profometer 6 dhe janë nxjerrur rezultate dalëse.

Gjatë projektimit të urave sidomos urave që kalojnë nëpër lumenjë duhet të shqyrtohet mundësia e erozionit pra të shqyrtohen prurjet maksimale të lumit që kanë ndodhur për një periudhë kohore relativisht të madhe në mënyrë që studimi të bëhet i mirëfilltë dhe fondimi i strukturës të bëhet adekuat në mënyrë mos të vie deri tek dëmtimet në strukturë dhe në shumë raste kallopsimi i strukturës. Mirëpo në raste të mungesave të të dhënave mundë të llogariten edhe ndikimet nga ngarkesat shtesë apo aksidentale ( cedimi, rrotullimi, mbingarkimi, goditjet etj) në mënyrë që në rastë se ndodhë ndonjëra nga këto të kemi rezerva optimale në strukturë në mënyrë që struktura të ju përballojë këtyre ngarkesave.

Dorëshkrimi i punimit është i atashuar në sekretarinë e Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe është i qasshëm për publikun. Çdo vërejtje, plotësim, ndryshim mund të deponohet me shkrim i protokolluar dhe do të merret për trajtim nga këshilli i Fakultetit të Ndërtimtarisë.